

Upgrade i sistemeve AIPS/ AIPS EURO, AECH

Prezantim KKSP – 2023

VALENTINA SEMI
Zëvendës drejtor, DSPKF





OBJEKTIVAT E PROJEKTIT



Upgrade i infrastrukturës teknike për Sistemet e Pagesave me qëllim rritjen e sigurisë dhe efikasitetit.



Mundëson implementimin e Standardeve të procesimit të mesazheve (SEPA / ISO 20022).



Sistem modern bazuar në funksionalitetet, teknologjitë dhe risitë më të fundit, i cili do të akomodojë dhe shumë nga zhvillimet e nevojshme strategjike të BSH.

MASAT E MARRA DERI TANI



Përcaktimi i objektivave

Në fazën e konceptimit të projektit janë identifikuar të gjitha nevojat e gjeneruara ndër vite

Është komunikuar me sistemin bankar mbi nevojat e tyre

Janë identifikuar të gjitha objektivat strategjike



ToRs

Janë finalizuar termat e referencës pas një diskutimi dhe analize me ofruesit e shërbimeve SWIFT/ Montran



Rishikimi i TORS – në proces

Aktualisht dhe deri në muajin Janar 2024, Bsh po punon për rishikimin dhe definimin në detaje të Termave të Referencës

SISTEMI NDËRBANKAR I PAGESAVE ME VLERË TË MADHE – AIPS/ AIPS EURO



Risitë Kryesore

Rezerva e Detyrueshme



Administrimi i RD

Mekanizëm më fleksibël administrimi

Periudhë variabël e mbajtjes

Përcaktimi i normave të interesit dhe penalitetit sipas pjesëmarrësit

Përcaktimi i parametrave të përdorimit të rezervës sipas pjesëmarrësit

Përcaktimi i tipeve të ndryshme të rezervave



Rregjistrimi i Rezervës

Mitigimi i rrezikut operacional dhe atij të likuiditetit

Ndarja e proceseve të hapje/mbylljes së ditës së punës nga shlyerja e regjistrimit për rezervën e detyruar

Mundësia për garantimin e fondeve përgjatë ditës së punës në ditën e parë të periudhës së mbajtjes së rezervës



Remunerimi për EURO

Implementimi i funksionalitetit për përllogaritjen e remunerimit të fondeve për llogaritë e shlyerjes



Rezervat dhe automatizimi

Shlyerjen e pozicioneve neto të sistemit AECH apo sistemeve të ngjashme me të, nëpërmjet krijimit automatik "rewind"

NDRYSHIME TË PËRBASHKËTA



ISO 20022

Pas upgrade, sistemi AIPS do të ketë të implementuar dhe do të jetë në përputhshmëri me standardin ISO 20022 XML, më konkretisht HVPS+ si standard për formatet elektronike të mesazheve financiare përcaktuar nga SWIFT.

Përrjashtimet/ kufizimet në sistem

Përrmirësim i funksionaliteteve për administrimin e proceseve të përrjashtimit/kufizimit në system.

Ndërfaqësimi

Përrqasja për standardizim të mënyrës së ndërfaqësimit me sistemet e lidhura me sistemin AIPS, do të ndihmojë që pjesëmarrës të rinj të natyrës së shtëpive të klerimit, sisteme të shlyerjes së letrave me vlerë, skema të kartave, etj., të mund të ndërliohen me lehtësi me sistemin AIPS.

Implementimi i Standardit ISO 20022 XML.

SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL –

AECH



Risitë Kryesore

SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL – AECH



1

ISO/ SEPA

Pas upgrade, sistemi AECH do të ketë të implementuar dhe do të jetë në përputhshmëri me standardin ISO 20022 XML, si dhe në përputhshmëri me bashkësinë e rregullave SEPA për Transferrat e Kreditit dhe Debitimet Direkte, bazuar në standardet relevante të mesazheve ISO 20022 XML.

2

Pjesëmarrja indirekte

Ofrimi në sistemin AECH i funksionaliteteve për administrimin e procesit të klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve AECH për pjesëmarrësit indirect.

3

“Rewind” i NSI

Mitigimi i rrezikut të likuiditetit – për shlyerjen e NSI të AECH dhe krijimin automatik të rezervës në AIPS.

Për raste ekstreme, do të mundësohet përdorimi i një mekanizmi për rillogaritjen (“rewind”) e pozicionit neto të pjesëmarrësve në shlyerje, duke përjashtuar nga NSI pjesëmarrësin në vështirësi.

4

Filet outgoing ne format XML nga AECH

Pas çdo fund sesioni të AECH, një file me pagesat *incoming* XML do të paraqitet automatikisht për çdo pjesëmarrës në sesionin e klerimit.



NDRYSHIME TË PËRBASHKËTA

NDRYSHIME TË PËRBASHKËTA



Përlogaritja e tarifave

Implementimi i një mekanizmi me fleksibël në aplikimin e tarifave ndaj pjesëmarrësve, me qëllim mbështetjen e politikave që mund të aplikohen në të ardhmen nga Banka e Shqipërisë.

Kompatibilitet me MT

Pavarësisht se formati primar elektronik i mesazheve financiare në sistem do të jetë ISO 20022 XML (HVPS+ SEPA), sistemi do të vijojë të suportojë dhe lexojë formatin MT të mesazheve deri në datën kur nuk do të suportohet me nga SWIFT, ose deri kur Banka e Shqipërisë të vendosë për përfundimin e përdorimit të tij.

Validimi i fushave

Sistemi do të ketë fleksibilitet më të madh në drejtim të konfigurimit të validimeve mbi fusha, ose aplikimit të kushteve për refuzimin e mesazhit, si dhe vendosjen e kufizimeve për përdorimin e opsioneve të caktuara, si pjesë e procesit të kontrollit të vlefshmërisë së mesazhit.

Mënyra e inicimit të pagesës

Me qëllim aplikimin e tarifave të ndryshme bazuar në mënyrën e inicializimit të pagesave, si dhe për arsye auditimi në lidhje me përputhshmërinë e pjesëmarrësve me kuadrin rregullativ, do të mundësohet përfshirja në mesazh e informacionit mbi mënyrën e inicializimit të pagesës.



RËNDËSIA E PROJEKTIT



Baza për projekte të tjera

Zbatimi me sukses i këtij projekti është domethënës për implementimin e projektit *Instant payment*, pjesëmarrjen në SEPA, dhe materializimin e Strategjisë së Pagesave me Vlerë të Vogël



BASHKËPUNIMI NË VIJIM



Krijimi i një grupi pune ndërbankar



Ndërmarrja e investimeve të nevojshme



Komunikim i vazhdueshëm dhe periodik



Testime




Kalimi *live* sipas afateve

AFATET E PROJEKTIT



Finalizimi i ToRs

Finalizimi i Fazës së rishikimit, Janar 2024



Implementimi

Përgatitje nga ana e BSH për zbatimin e projektit
dhe testime nga pjesëmarrësit deri në Dhjetor
2024



Faleminderit!

Pyetje ???